

DEGA: GAZETARI

PROGRAMI I STUDIMEVE: BA

SILABUSET E LËNDËVE: **SOCIOLOGJI E KOMUNIKIMIT**

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gazetarisë
Titulli i lëndës:	Sociologji e Komunikimit
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	zgjedhore
Viti i studimeve:	viti i II-të, semestri i III-të, Bachelor
Numri i orëve në javë:	2 + 2
Kreditë ECTS:	5
Koha / Vendi:	E merkure 16-17:30 salla 51
Mësimdhënësi:	Prof. ass. Remzie Shahini-Hoxhaj, PhD
Të dhënat kontaktuese:	remzie.shahinihoxhaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Kjo lëndë semestrale për nivelin Bachelor trajton shoqërinë dhe mediat në një këndvështrim sociologjik. Lënda poashtu ofron njohuri themelore mbi kontekstin shoqëror dhe teknologjik të komunikimit. Merret me konceptet e përgjithshme teorive raport të ngushtë me komunikimin dhe mediat si dhe ndikimin e tyre nga aspekti teknologjik.
Qëllimet e lëndës:	Kjo lëndë do të ju shërbejë studentëve të ndërtojnë, ngritin dhe testojnë vlerat e tyre në sferën e medias dhe shoqërisë. Poashtu të stimulojë mendimin kritik me qëllim të përpunimit, sajimit dhe diskutimit të aspekteve ndikuese të mediave në shoqëri. Në fund të këtij kursi studentët duhet të jenë gjendje ta njohin audiencën që i drejtohen.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Të definojnë, njohin dhe të praktikojnë konceptet bazë të: shoqërisë dhe ambientit social, mediatik e kulturor dhe të publikut Ideja themelore e kësaj lënde është që studenti i këtij niveli të kuptojë termet dhe konceptet bazë lidhur me: studimet mbi

		komunikimin, korrelacionin midis shkencave sociale me sfidat mediatike dhe konceptet mbi determinizmin teknologjik	
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Punë praktike/Ushtime	2	15	30
Përgatitje për test intermediar			0
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.5
Puna në terren			0
Testi, punimi i seminarit			0
Detyrë shtëpie	2	6	12
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	5	15
Përgatitja për provimin final	3	4	12
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	7	3	21
Projektet, prezantimet, etj.	2	1	2
Total			124,5
Metodat e mësimdhënies:		Ligjërata do të ndahen në pjesën e ligjërimit, referateve të shkurta dhe pjesë së diskutimit. Studentët do të ftohen mbledhin njohuri nga literatura shtesë për secilën njësi mësimore dhe të prezatojnë tema nga njësit që zhvillojmë në klasë.	
Metodat e vlerësimit:	20% Pjesëmarrja aktive në ushtime 20% Detyrat 20% Prezantimet 40% Provim përfundimtar		
Literatura primare:	Eric Maigret, Sociologjia e Komunikimit dhe e Mediave, Papirus, Tiranë, 2010 Media & Society Croteau, D.R., Hoynes, W. & Childres, C (2021). Media/Society. Technology, Industries, Content, and Users. Seventh Edition. SAGE Publications, Inc		

	Instrumentet e Komunikimit – Media si zgjatim i njeriut, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit - IDK, Tiranë Berisha, Ibrahim. 2009. Media – Agjensët e komunikimeve, Universiteti AAB, Prishtinë David Barrat, Media Sociology, Taylor & Francis Routledge, 2007 Simon Lindfren, Digital Media and Society, SAGE Publications, 2017 Gidenns, Anthony. 2004, Sociologjia, Botime Çabej, Tiranë
Literatura shtesë:	Fetoshi, A. & Shahini-Hoxhaj, R. (2023). The Impact of the Media in Election Campaign During the COVID-19 Pandemic: The Case of Kosovo. Central European Journal of Communication. Vol.16, 1/33. p. 59-78 https://journals.ptks.pl/cejc/article/view/507/pdf Shahini-Hoxhaj, R. (2018). Facebook and political polarization: An analysis of the social media impact on the Kosovo-Serbia dialogue. Journal of Media Research-Revista de Studii Media. Vol.11, 32. p. 71-93 https://www.mrjournal.ro/docs/R2/32jmr6T.pdf Zamora-Medina, R., Shahini-Hoxhaj, R., Gërguri, D. (2025). Building Political Identity through Visual Affective Polarisation on Instagram: A Comparison of Six European Far-Right Parties. KOMÉ. Volume 13/1 https://folyoirat.ludovika.hu/index.php/kome/article/view/7789

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Hyrje Prezantimi i syllabusit
Java 2:	Komunikimi interpersonal dhe masiv
Java 3:	Komunikimi sot në kohën e ekspansionit teknologjik. A është familja celula e shoqërisë apo interaksioni
Java 4:	Modeli i katërorit të informatës dhe katër veshëve
Java 5:	Shkolla e Çikagos dhe pragmatizmi amerikan

Java 6:	<i>Teoria mbi Shenjat – Saussure, Barthes dhe Eco</i>
Java 7:	<i>Modeli i Palo Altos – Paul Watzlawick</i>
Java 8:	Shkolla e Frankfurtit – teoria kritike
Java 9:	Teoria e Efekteve të Drejtpërdrejta- “ <i>shiringa hipodermike</i> ”
Java 10:	Studimet kulturore – Stuart Hall
Java 11:	Studimet kulturore – John Fiske
Java 12:	Studimet kulturore – Raymond Williams
Java 13:	Agenda Setting
Java 14:	Framing
Java 15:	Teorite e sferes publike

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

- ✓ Studentët duhet të jenë me kohë në klasë, rregull që vlen edhe për mësimin online.
- ✓ Studentët duhet ta vijojnë rregullisht modulin. Më shumë se tri mungesa ndikojnë në notën përfundimtare dhe duhet shqyrtuar pjesëmarrja juaj në provimin përfundimtar
- ✓ Studentët duhet të jenë social dhe ti sfidojnë kolegët dhe anasjelltas, në suaza të sjelljeve demokratike të një debati.
- ✓ Studentët duhet ti dorëzojnë detyrat me kohë. **Punimet e vonuara nuk do të merren parasysh!**
- ✓ Studentët duhet ti mbajnë telefonat e çkyçur (fikur) gjatë orëve të mësimit, ndërsa gjatë orëve online kamerat e ndezura!

Kopjimi dhe plagjiatura : Studentët të cilët në punimet e tyre kopjojnë apo bëjnë plagjiaturë do të raportohen në organet udhëheqëse të Universitetit!